

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Projekti i Sazanit dhe Zvernecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/projekti-i-sazanit-dhe-zvernecit-te-jashtezakonshem-per-ek-omine-s-i516242
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:02:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 18:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a3ebd32729a590bcf49cd46a366f7e45e4d68fae48accfca136054ba4a500809
TEKSTI	892caaf67d97a77aabd7417ac6956e4a596fa95fb88a9626dfcbf6e6639a1fc8
PAMJA	bc9304b4c3c180896d4c130f98e95f5166639b5a50fa03923f8eb4980aec62a3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	04089052018e94435526e8a7a773e9c36b458ac695ad7d4ed41531b05e0c6705
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/04089052018e94435526e8a7a773e9c36b458ac695ad7d4ed41531b05e0c6705>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

15 SEKONDA ME PARE

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

2 ORE ME PARE

Dita e 119-të e protestës/ Qytetarët zbrisin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

5 ORE ME PARE

Ceremonia e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, Berisha: Nuk kam dijeni, në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare nuk jam ftuar

7 ORE ME PARE

Shpërthimi i fuqishëm në lagjen Plaka në Greqi/ Humbin jetën 6 persona, mes tyre dhe 3 shqiptarë të pjetë në rrënoja (EMRAT+PAMJET)

LIVE UPDATES

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

• Kryeministri i vendit, Edi Rama zhvilloi këtë mbrëmje një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York. • Gjatë fjalës së tij në këtë takim, Rama foli për protestën në SHBA, projektin e Sazanit dhe Zvërnecit si dhe diasporën shqiptare dhe marrëdhënien me të. • Në lidhje me këtë të fundit, Rama u shpreh se gjatë dekadës së fundit janë krijuar ura të reja bashkëpunimi në investime, ekonomi dhe rikthimin e shqiptarëve në vendlindje. • Lideri i qeverisë argumentoi se marrëdhënia mes Shqipërisë dhe diasporës ka kaluar nga mbështetja financiare e familjeve drejt një partneriteti më të gjerë. • Kryeministri bëri me dije se ka nisur krijimi i regjistrimit kombëtar të diasporës, për të gjithë ata që kërkojnë të investojnë në Shqipëri. • Duke folur për protestën e qytetarëve shqiptarë në SHBA, ku ata e qëlluan me vezë, ai tha me ironi se një prej personave që mori pjesë në protestë kishte ardhur nga Britania për t'i hedhur vezë, duke shtuar se kjo situatë e bëri të ndihej si në Tiranë. • Më tej, ai u ndal edhe tek "Paketa e Maleve", për të cilën tha se është hartuar për të zgjidhur problematikën e ndarjes së pronave në male dhe për t'u dhënë mundësi pronarëve të zhvillojnë pronat e tyre. • Rama foli sërish për projektin e Sazanit dhe Zvërnecit, duke i cilësuar si projekte të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare. • Gjatë fjalës së tij në një takim me komunitetin shqiptar ai tha se Shqipëria po synon turizmin e vlerës, me qëllim sjelljen e më shumë përfitimeve ekonomike për popullin shqiptar. • Rama deklaroi se vetëm projekti në Zvërnec parashikohet të sjellë mbi 4 miliardë euro, duke theksuar se ekonomia shqiptare është rreth 27 miliardë euro. • Më tej, ai theksoi se qeveria po studion edhe më tej që këto projekte mund të sjellin në mjedis, duke hartuar një studim të plotë mbi risqet reale.

4 artikuj për këtë temë.

14 MINUTA ME PARE

"Po studiojmë risqet që mund të sjellë në mjedis"/ Rama nga SHBA: Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare



editoriale

Auron Janku
"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli
Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Në vëmendje



Edi Rama


SHBA- Kryeministri i vendit, Edi Rama ka folur sërish për projektin e Sazanit dhe Zvërnecit, duke i cilësuar si projekte të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare. Gjatë fjalës së tij në një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York, Rama tha se Shqipëria po synon turizmin e vlerës, me qëllim sjelljen e më shumë përfitimeve ekonomike për popullin shqiptar.

Rama deklaroi se vetëm projekti në Zvërnec parashikohet të sjellë mbi 4 miliardë euro, duke theksuar se ekonomia shqiptare është rreth 27 miliardë euro. Më tej, ai theksoi se qeveria po studion edhe mësin që këto projekte mund të sjellin në mjedis, duke hartuar një studim të plotë mbi risqet reale.

Edi Rama: Këtë synim ka projekti i shumë diskutuar, projekti i famshëm, por edhe fatkeq për fat të keq, si rezultat i shumë gënjeshtërave, manipulimeve, denigrimeve. Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, një projekt që sjell vetëm në Zvërnec më shumë se 4 miliardë euro, në një ekonomi që në totalin e vet është 27 miliardë euro. Një projekt i jashtëzakonshëm për Shqipërinë. Është jashtëzakonisht delikat edhe në aspektin e ekuilibrit për mjedisin, prandaj ne po punojmë shumë për të pasur një studim për ndikimin dhe risqet në mjedis. Risqet reale dhe jo ato që prodhohen në rrjetet sociale nga sharlatanët e manipulorët. Shpresoj që kur të vini në Shqipëri, kryepolici të na japë mundësi që të takohemi. Para se të vija këtu, më mori në telefon Dritani nga Mali i Zi, ish-kryeministri dhe miku im i shtrenjtë, i vetmi qytetar i botës në Ballkan, i cili më tha 'shiko se atje ku po shkon, te ajo dallga shqiptare, ke edhe disa shkurme nga Ulqini. Kështu që shumë faleminderit./Dosja.al

24 MINUTA ME PARE

“Besoj se keni dëgjuar të mirat dhe të këqijat për paketën e maleve”/ Rama u prezanton shqiptarëve në New York nismën e re: Është bërë për të gjithë ju



Edi Rama

SHBA- Kryeministri i vendit, Edi Rama po zhvillon këtë mbrëmje një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York. Gjatë fjalës së tij në këtë takim, ai foli për paketën e maleve duke hedhur poshtë akuzat se është krijuar për përfitime të paligjshme nga pronat në zonat malore. Ai deklaroi se kjo nismë është hartuar për të zgjidhur problematikën e ndarjes së pronave në male dhe për t'u dhënë mundësi pronarëve të zhvillojnë pronat e tyre.

“Besoj se keni dëgjuar të mirat dhe të këqijat për paketën e maleve, që ju thonë se është bërë për të vjedhur, por në të vërtetë paketa e maleve është bërë për të gjithë ju. Është ekskluzivisht për të adresuar një problematikë të ligjit, i cili nuk e ka zgjidhur dot çështjen e ndarjeve të pronave në male. Paketa e maleve u jep mundësinë gjithkujt, që të paraqitet në bashkinë përkatëse, për të zhvilluar pronën e vet. Unë gjithmonë e kam besuar, që pavarësisht se turizmi në Shqipëri identifikohet me detin, por momenti që Shqipëria do të ngrihet në lartësinë e vet, do të jetë momenti kur malet të ngrihen në lartësinë e vet. Prandaj qëndrova te paketa e maleve për t'iu siguruar që paketa e maleve është bërë për ata që kanë pronën atje dhe për askënd investitor tjetër.”, u shpreh ai./Dosja.al

29 MINUTA ME PARE

“U ndjeva si në Tiranë”/ Rama për protestën në SHBA: Njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

Atentati në Athinë/ Në shënjestër 30-vjeçari Denis Luli! Dyshimet se urdhri u dha nga Klodian Lekocaj, i njohur si kreu i mafies së burgjeve

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:36

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:14

U arrestua nga SPAK gjatë operacionit “Muri i Lartë”/ Kush është Bledar Çafi, “i forti” i Shkodrës ndër vite i përfshirë në botën e krimit

më të klikuarat

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës

Aksioni i SPAK kundër grupit Rraja/ Shkon në 17 numri i të dyshuarve, Indrit Dokle i akuzuar për trafik ndërkombëtar droge



SPAK operacion në Shkodër e Tiranë/ Goditet një grup kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

Atentati në Athinë/ Në shënjestër 30-vjeçari Denis Luli! Dyshimet se urdhri u dha nga Klodian Lekocaj, i njohur si kreu i mafies së burgjeve

insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB



Edi Rama

SHBA- Kryeministri i vendit, Edi Rama po zhvillon këtë mbrëmje një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York. Gjatë fjalës së tij në këtë takim, Rama foli edhe për protestën e qytetarëve shqiptarë në SHBA, ku ata e qëlluan me vezë.

Në lidhje me këtë ai tha me ironi se një prej personave që mori pjesë në protestë kishte ardhur nga Britania për t'i hedhur vezë, duke shtuar se kjo situatë e bëri të ndihet si në Tiranë. Rama u ndal edhe te marrëdhënia me diasporën shqiptare, duke vlerësuar kontributin e emigrantëve për familjet dhe ekonominë e vendit.

Në lidhje me këtë, lideri i qeverisë argumentoi se marrëdhënia mes Shqipërisë dhe diasporës ka kaluar nga mbështetja financiare e familjeve drejt një partneriteti më të gjerë. Kjo përfshin sipas tij, investimet, angazhimin dhe rikthimin e shqiptarëve në vendlindje.

Edi Rama: Faleminderit për mikpritjen. Të them të drejtën kur na thanë mbrëmë se një stuhi e madhe po vinte menduam se do të ishte pengesë që të mbledheshit këtu, ju jo vetëm u mbloodhët, por ndaluat edhe stuhinë nga ajo që parashikohej. Më vjen mirë që jam këtu, ku thonë se është i vetmi vend në botë, ku mund të gjedh Ismail Qemalin, Isa Boletinin dhe Ruselvtin pranë njëri-tjetrit.

Jemi në Amerikë, por ky është një territor i pushtuar jozyrtarisht nga shqiptarët. Jemi këtu për të ndarë disa gjëra që kanë ndodhur në të shkuarën. Këtu në Staten Irelant në 2015-ën unë isha në një darkë së bashku me Hashim Thaçin dhe këtu diskutuam për samitin e parë të Diasporës në Tiranë dhe ishim bashkë me Thaçin. Një dekadë pas samitit kanë ndodhur shumë gjëra.

Çdo gjë lidhej me dërgesat që shqiptarët dërgonin për të mbajtur familjen, por tashmë shumëçka ndodh dhe janë ndërtuar ura me interesa, interesa, investime dhe rikthime shqiptarësh në tokën amë. Në këto vite ka një fakt të jashtëzakonshëm që e vendos çdo emigrant në një pedestal të posaçëm. Çdo familje shqiptarë ka përfutur nga dërgesat financiare të diasporës, ku 9 nga 10 shqiptarë, kanë ndërtuar çati mbi kokë, janë shkollat apo kanë përmirësuar jetën falë çdo të afërmi në diasporë.

Ky është një nder i madh që e mbulon me lavdi diasporën. Por siç e thashë nuk jemi më në fazën që diaspora jepte dhe Shqipëria vetëm merrte, por jemi në një lidhje dhe partneritet të fortë, që ka hyrë në rrugëqin e një zhvillimi dhe ku sot kemi organe të një trupi të ri që kemi ndërtuar. Institucionet e diasprës, këshillet, agjencitë dhe samitet që ndihmojnë për angazhime të ndryshme.

Po krijomë një regjistrë kombëtar të diasporës si një dritare për ata që duan të investojnë sadopak në Shqipëri. Organicitetin ishin edhe vezët që më hodhën mua para pak netësh, duke treguar se ajo çka ndodh në Shqipëri i ka integruar shqiptarët. Një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Britania përtë hedhur vezë,. Shpresoj të ketë kaluar mirë me policinë e Neë Yorkut.

Pastaj në trupën e angazhuar kryesor ishte një shqiptar që punonte këtu. Falë kësaj ndërlidhjeje mes Shqipërisë dhe diasporës, u ndodha fiks si në Shqipëri, me protesta dhe me plot shqiptarë. U prita me një tortë rozë me dy flamingo sipër dhe u ndjeva shumë mirë.

Nuk vuajmë më faktin që kafshët e natyra vritet dhe nuk merret më njeri me të, por kafshët dhe natyra mbrohen dhe njerëzit shqetësohen. Ka ardhur koha kur Shqipëria thotë se ka edhe më mirë dhe është e vërtetë që ne së bashku mund të bëjmë çdo ditë e më mirë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Kur pa që mu hodhën ca vezë erdhi me vrap kryepolici i Shqipërisë, Pjerin Ndreu. Një nga kryetarët më të mirë të bashkive, që vuan edhe nga fakti që Lezha nuk bëhet kryeqytet, më la porosi të them diçka për lezhjanët sepse ka të tillë në sallë. Jeni me fat që e keni./Dosja.al

36 MINUTA ME PARE

Rama takim me shqiptarët në New York: Kemi

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gaganj
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow

nisur të krijojmë regjistrin kombëtar të diasporës



Edi Rama

SHBA- Kryeministri i vendit, Edi Rama po zhvillon këtë mbrëmje një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York. Gjatë fjalës së tij në këtë takim, Rama u shpreh se lidhja mes Shqipërisë dhe diasporës ka hyrë në një fazë të re partneriteti.

Në lidhje me këtë, ai tha se gjatë dekadës së fundit janë krijuar ura të reja bashkëpunimi në investime, ekonomi dhe rikthimin e shqiptarëve në vendlindje. Lideri i qeverisë bëri me dije se ka nisur krijimi i regjistrit kombëtar të diasporës, për të gjithë ata që kërkojnë të investojnë në Shqipëri.


Edi Rama: Pavarësisht se jemi në Amerikë, ky është një territor jo zyrtarisht i pushtuar nga Shqiptarët. Jemi këtu për të ndarë diçka që kanë ndodhur këto vite. Në vitin 2015, unë isha këtu në një darkë shqiptarët i ftuar bashkë me Hashim Thaçin dhe në atë darkë u diktua ideja e samitit të diasporës, që u bë në Tiranë.

10 vjet prej atij samiti, kanë ndodhur plot gjëra pozitive. Lidhje me diasporën, është kthyer një lidhje ku shumëçka tjetër ndodh dhe janë ngritur ura mbi të cilat kalojnë interesa, investime dhe shumë rikthim shqiptarët në tokën mëmë, qoftë për të bashkëfinancuar me miq e të afërm për projekte të ndryshme, qoftë edhe për të qëndruar në Shqipëri. 90% e familjeve shqiptare kanë përfutur të paktën një herë nga dërgesat financiare të diasporës. Ky është një nder i madh që do e mbulojë me lavdi diasporën shqiptare.

Nuk jemi më në atë fazën ku diaspora jepte dhe Shqipëria merrte, por jemi në atë fazë ku diaspora është një lidhje më e fortë dhe në partneritet. Sot kemi organe të një trupi krejt të ri për diasporën. Nga samitet shqiptare dolëm në strategjinë e diasporës 2030, e cila ka qeverisjen, ekonominë dhe inovacionin, si dhe gjuhën e kulturën për diasporën. Kemi nisur të krijojmë regjistrin kombëtar të diasporës, për të gjithë ata që kërkojnë të investojnë sado pak, apo shumë në Shqipëri. **Dosja.al**

Sondazh

Poll






Kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare



Berisha i uron mirëseardhjen ambasadorit të ri: SHBA do të japë një ndihmë substanciale



Berisha: Provat direkte më të mëdha i kam për Edi Ramën, por SPAK nuk guxon ta thërrasë



Berisha: Ai është armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër Vetëvendosjes

Kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

 Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE 

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta,

AKTUALITET
POLITIKE

Drejtör: Enton Abilekaj

Kontakt: 069 999 9999

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.